



Universiteti Bujqësor i Tiranës



Shoqata e Industrisë së Bimëve Mjekësore dhe
Aromatike "IBMA"

Nr. 2537 Prot.

Datë 10/09/2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NDËRMJET

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

DHE

SHOQATES SE INDUSTRIJË SË BIMËVE MJEKËSORE DHE AROMATIKE

Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Universitetit Bujqësor të Tiranës, e quajtur më poshtë **UBT** me adresë Rruga Pajsi Vodica Tiranë, përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Fatbardh Sallaku dhe Shoqatës së Industrisë së Bimëve Mjekësore dhe Aromatike, e quajtur më poshtë **IBMA**, me seli në adresën Bulevardi Gjergj Fishta (Zhan D'Ark), Pall E88, 12/ zyra 9, Tirane përfaqësuar nga z. Filip Gjoka

Palët e mësipërme bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë "Marrëveshja") është bashkëpunimi ndërmjet Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe Shoqatës së Industrisë së Bimëve Mjekësore dhe Aromatike për fushat si më poshtë vijon:

- a. Përmirësimi i standardeve të cilësisë përmes shkëmbimit të njohurive midis Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe sektorit privat në sektorin e Bimëve Aromatike dhe Mjekësore (BAM)
- b. Demonstrim dhe zhvillim i metodave dhe i praktikave të mira bujqësore që kanë në fokus zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor në sektorin e BAM;
- c. Realizimi i aktiviteteve trajnuese për sektorin e BAM;
- d. Projekte të përbashkëta të testimit për futjen e varieteteve apo bimëve të reja të BAM nëpërmjet studimeve gjenetike dhe provave fushore rajonale.
- e. Projekte të përbashkëta të përmirësimit të teknologjive të kultivimit të BAM nëpërmjet provave fushore dhe rajonale.
- f. Realizim i praktikave profesionale të studentëve pranë Bizneseve të BAM;

Neni 2

Marrëveshja e bashkëpunimit do të mbështetet mbi bazën e legjislacionit në fuqi. Palët zotohen që të mirekuptojnë nevojat e përbashkëta gjatë bashkëpunimit të tyre me qëllim për të përfutur nga zhvillimi dhe shkëmbimi shkencor e profesional.

Neni 3

Bashkëpunimet e mbështetura në këtë marrëveshje do të përcaktohen me detaje në kërkesat e palëve dhe më pas do të firmosen nga përfaqësuesit e autorizuar të secilës palë.

Neni 4

Kjo marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet në 2 kopje në gjuhën shqipe. Kjo marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh. Në rast se asnjëra nga palët nuk shpreh vullnetin për t'i dhënë fund, marrëveshja ripërtërihet edhe për një periudhë tjetër 3 (tre) vjeçare.

Në çdo rast, secila nga palët nënshkruese mund t'i japë fund marrëveshjes duke shprehur vullnetin e saj me shkrim, të paktën 3(tre) muaj më parë.

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve do të zgjidhet me mirëkuptim dhe bisedime.

Neni 5

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e firmosjes nga përfaqësuesit e palëve pjesëmarrëse në marrëveshje.

Për Universitetin Bujqësor të Tiranës

Rektori

Prof. Dr. Fatbardh Sallaku.



**Shoqata e Industrisë së Bimëve
Mjekësore dhe Aromatike**

Presidenti

Filip Gjoka